




REPUBLIKA E KOSOVË		REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT		AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep:	2-D/DPK	Nr Prot:	01-804/15
Dep:		Prot No:	
Nr. f. sh.		Data:	19-03-2015
Broj. sh. lista:	02	Datum:	
Nr. pages:		Day:	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.03.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-341-15 për *znj.Minavere Maka-Këshilltare në Asamblenë Komunale Dardanë, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-341-15, për Zyrtaren e lartë, znj.Minavere Maka-Këshilltar në Asamblenë Komunale Dardanë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj.Maka fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./DPK-01-471/15), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtarja e lartë, znj.Maka, është deklaruar se biznesi në fjalë ka kohë që është pasiv, por ka mbetur i regjistruar. Megjithatë ajo premtoj se do të bëjë shuarjen vullnetare ose do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, znj.Maka, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK/DPKI-03-02-767/15) në të cilën shihet se biznesi N.P.T."Amarda" është shuar në mënyrë vullnetare. Tani znj.Maka ushtron pa konflikt interesi funksionin e saj publik - Këshilltare komunale në Komunën e Dardanës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni